



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit  
Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 08.11.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303.

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu; Bahrim Shabani; Glauk Konjufca; Arben Gashi;  
Korab Sejdiu; Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Hajdar Beqa, Sami Kurteshi, Agim Aliu dhe Jelena Bontiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dibran Istrefi- Klan Kosova; Sanije Berisha-OSCE; Fitore Ademi-RTV21; Gresa Ramadani-LVV; Albana Bajrami-RTK-Radio; Ardiana Thaqi-KTV; Diana Berisha IKD; Hyd Kelmendi-Ekonomia Online; Gramoz Paqarada-KDI; Behxhet Shala-KMDLNJ; Qëndresë Mustafa-BIRN; Fitore Zena-Praktikante.

**Nga Staf i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, Kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 30.10.2017;
3. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me kandidatet për anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës;
4. Shqyrtimi i propozimit të Fakultetit Juridik për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim;
6. Të ndryshme.

**Albulena Haxhiu**-në lidhje me pikën tre të rendit të ditës tha se është ftuar Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri që të arsyetojë propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kandidatët për anëtarë të Komisionit për Provim të Jurisprudences, por i njëjti nuk do të jetë i pranishëm në këtë mbledhje edhe pse ka konfirmuar pjesëmarrjen.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua .*

### **2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me 30.10.2017;**

*Kryesuesja - konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.10.2017, pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me kandidatet për anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës;**

**Albulena Haxhiu**,sa i përket kësaj pike tha se deklaratat e Ministrit ku thotë:”se do ti pezullojmë emrat për anëtarë të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës” ajo tha se Rregullorja e Punës nuk njeh pezullim të procedurave,në deklaratën e dytë Ministri thotë se do të tërheq vendimin, ndërsa tani kemi shkresë tjetër ku i referohet nenit 4 paragrafi 2 i ligjit 04/L-141 dhe Rregullores së Punës së Kuvendit neni 56 pika 5 ku për arsye objektive thotë se tërheq propozim vendimin për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Provim të Jurisprudencës. Në vazhdim deputetja Haxhiu theksoi se asnjëra nga këto shkresa nuk është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit kur dihet se vendimi vjen nga Qeveria dhe tërheqjen e këtij vendimi do të duhej ta bënte Qeveria.

**Arben Gashi**, sa i përket procedurës tha, meqë i kemi tri shkresa kundërthënëse njëra me tjetrën do të ishte mirë që kjo çështje të mos trajtohet fare nga komisioni dhe kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës deri sa Qeveria të marrë vendim në lidhje me këtë çështje theksoi deputeti Arben Gashi.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se përkrahë deputetin Arben Gashi që kjo çështje të mbetet për ndonjë mbledhje të radhës dhe të pritët deri në një vendim të Qeverisë.

**Albulena Haxhiu**, në fjalën e saj të sërishme paraqiti vërejtje në lidhje me emrat e propozuar ku tha se është e papranueshme që për kryetar të këtij komisioni të propozohet personi i cili është në hetim për provimin e jurisprudences, gjithashtu disa nga anëtarët tjerë të propozuar nuk i plotësojnë kushtet me ligjin për provimin e jurisprudencës. Ajo në vazhdim tha se Ministria e Drejtësisë duhet të ketë parasysh kushtet të cilat parashihen në ligjin për Provimin e Jurisprudencës sa i përket përvojës që kërkohet.

**Arben Gashi**, tha se komisioni duhet të kërkojë nga Qeveria të trajtojë në mënyrë procedurale dhe formale këtë çështje në mënyrë që pastaj komisioni të procedojë tutje, pra komisioni e pezullon deri në vendimin e Qeverisë thesdoi z. Gashi.

**Shkumbin Demaliaj**, duke mos dashur të flas për mënyrën se si është hartuar lista me emrat e propozuar thesdoi se Qeveria duhet të tregoj saktë se çka ka ndërmarrë në lidhje me këtë vendim, ku shtoi duke thënë se kjo çështje është shumë me serioze nga ajo çka paraqitet këtu për arsye se në sistemin e drejtësisë një kolezion i tillë nuk është dashur të ndodhë në asnjë mënyrë.

**Glauk Konjufca**, tha se mund të ndodhë që emrat janë propozuar para se të del në opinion çështja Lumezi dhe meqë kemi të bëjmë me një çështje që po i kontesohet Lumezit pra dhënia e Provimit të Jurisprudencës kjo paraqet problem të dyfisht për shkak se personit që i kontestohet Provimi i Jurisprudencës të caktohet nga Qeveria si kompetent dhe përgjegjës kryesor për vlerësimin e të tjerëve thesdoi z. Konjufca. Në vazhdim tha se meqë ka shkelje të shumfishtë Qeveria do të duhej të shqyrtojë përmbajtjen e këtyre emrave të propozuar.

**Bilall Sherifi**, në fjalën e tij tha se këta emra kanë qenë të përgaditur shumë më herët në Qeveri por ajo çka duhet të bëhet është të rishikohen këta emra së paku kushtet në aspektin formal.

**Korab Sejdiu**, tha se duke pasur parasysh se Provimi i Jurisprudencës është një test lidhur me gadishmërinë për qasje të anës praktike të drejtësisë, kishte me qenë mirë që në rishikimin e emrave të propozuar të ketë edhe përfaqësues nga Avokatura si kategori kushtetuese duke ditur që në të kaluarën ka ekzistuar një përfaqësues nga ky profesion thesdoi z. Sejdiu.

**Albulena Haxhiu**, tha edhe pse komisioni ka pasur vërejtje edhe në të kaluarën, nuk ka pasur të drejtë të kthejë emrat e propozuar kur dihet se sipas ligjit këtë kompetencë e ka Ministri i Drejtësisë. Deputetja Haxhiu propozoi që të bëhet një shkresë për Qeverinë në lidhje me emrat e propozuar dhe asaj shkrese ti bashkangjiten edhe vërejtjet që anëtarët e komisionit kishin qoftë për kushtet formale qoftë për çështje tjera të ngritura si shqetësime potencoi deputetja Albulena Haxhiu.

Pasi nuk kishte diskutime tjera:

*Komisioni nuk e shqyrtoi propozimin e theksuar dhe në lidhje me këtë kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të sqarojë nëse qëndron pas vendimit nr. 05/09 të datës 20 tetor 2017 apo e tërheq propozimin, siç është kërkuar nga Ministri i Drejtësisë.*

#### **4. Shqyrtimi i propozimit të Fakultetit Juridik për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;**

Komisioni për Legjislacion, shqyrtoi shkresën nr. 3/73, me të cilën propozohen kandidatët për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 3 të Ligjit nr.05/L-035.

Pas diskutimeve, Komisioni vlerësoi se dosja e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Këshillit Prokurorial nga radhët e Fakultetit Juridik nuk është e kompletuar.

Dhe duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni kërkon nga propozuesi që:

1. Kandidatëve të propozuar, t'i bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm (CV-të) dhe,
2. Të sqarohen procedurat e ndjekura nga Fakulteti Juridik për nominimin e këtyre kandidatëve.

#### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim;**

**Albulena Haxhiu**, në fjalën e saj tha se kishte disa vërejtje lidhur me disa nene të këtij projektligji, por theksoi se të gjitha vërejtjet do ti paraqesin të detajuara edhe në senacë plenare.

**Arben Gashi**, tha se në parim përkrahë këtë Projektligj, që gjatë shqyrtimit nen për nen të do ti paraqesim të gjitha vërejtjet.

**Glauk Konjufca**, ngriti shqetësim me mënyren e formulimit të emrit të ligjeve në Republikën e Kosovës. Ai tha se secili emer i ligjit duhet të specifikohet saktë për fushën që mbulon në mënyrë që mos të ketë paqartësi në opinion.

*Pas diskutimeve, Kryetarja Konstatoi se me pesë (5) vota për dhe dy (2) apsetime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;*

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim,Projektligji nr.06/L-009 për Ndërmjetësim.

#### **6. Të ndryshme.**

**Albulena Haxhiu**, njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin që kanë pasur kryetarët e Komisioneve Parlamentare në Komisionin për Punë të Jashtme për të diskutuar për fazën e re të dialogut me Serbinë. Ajo në vazhdim e informojë Komisionin se në këtë mbledhje në bazë të diskutimeve janë nxjerrë disa rekomandime ku tha se ka kërkuar që këto rekomandime të procedohen te kryetarët e komisioneve në mënyrë që pastaj të shpërndahen te anëtarët e komisioneve që të dakordohen për hapa të mëtejshëm.

Lidhur me këtë njoftim të kryetares Haxhiu reagues deputetët **Bilall Sherifi** dhe **Arben Gashi** ku thanë se një kryetar i komisionit në këto takime nuk mund të paraqesë qëndrimin e komisionit, kur dihet se anëtarët e komisionit nuk kanë qëndrime të njëjta, gjithashtu në reagimin e tyre theksuan se në këto takime mund të paraqiten vetëm qëndrime individuale ose si deputet, megjithatë nuk përjashtuan mundësinë që idetë e dalura nga ky takim t'u dërgohen deputetëve si informatë.

**Albulena Haxhiu**, u sqarua duke thënë se kishte pasur qasje shumë korrekte në këtë diskutim, duke paraqitur qëndrim vetëm si kryetare e komisionit dhe si deputete, ajo theksoi se nuk ka paraqitur qëndrim në emër të komisionit ku tha se ekziston edhe transkripti nga ky takim.

**Albulena Haxhiu**, njoftoi anëtarët e komisionit se i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës me një shkresë ku ka kërkuar dokumentin e prezantuar gjatë raportimit të Ministrit të Drejtësisë z. Abelarad Tahiri por tha se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Këshilli Gjyqësor edhe pse kanë kaluar dhjetë ditë prej kur është dërguar shkresa. Ajo tha se në kërkesën e dërguar Presidentit për procedurat e dekretimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Presidenti është përgjigjur në afat ligjor. Gjithashtu tha se nga Presidenti ka kërkuar çasje edhe në dokumentet e betimit të gjyqtarëve shqiptarë dhe komuniteteve tjera që janë bërë në të kaluarën, kjo vetëm për qëllimin që të bëhet krahasimi i dy dokumenteve, pra deklarata e betimit që e bëjnë gjyqtarët dhe prokurorët tjerë, pra tani pres edhe këto dokumente ku komisioni do të ketë në disponim tha mes tjerash deputeja Albulena Haxhiu.

**Korab Sejdiu**, tha se në emër personal i ka dërguar Këshillit Gjyqësor një kërkesë lidhur me shtojcat e marrëveshjes së Drejtësisë, por nuk janë përgjigjur brenda afatit ligjor. Por meqë kryetarja Albulena Haxhiu ka bërë kërkesë në emër të komisionit, do të ishte mirë të dihen procedurat tjera që duhet të ndjeken që të sigurohemi që këto kërkesa të adresuara të realizohen e mos të mbeten vetëm kërkesa fillestare, theksoi deputeti Korab Sejdiu.

Mbledhja përfundojë ne orën 11:43

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

**Albulena Haxhiu**

---

